

LIGJ
Nr.7635, datë 11.11.1992

"PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.4624, DATË 24.12.1969 "PËR SISTEMIN E RI ARSIMOR"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.4624, datë 24.12.1969 "Për sistemin e ri arsimor", paragrafi i dytë neni 7, ndryshohet si vijon:

"Kur nxënësit e moshës 6-16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit, birësuesit ose kujdestarët e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë.

Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30-50% të kohës në dy muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është nga 200 deri në 400 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti gjoba është deri në 600 lekë. Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye mbi 50% të kohës në dy muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është nga 600 deri 800 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti, gjoba është deri në 1000 lekë.

Përfshihen nga masa e gjobitjes ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë të huaj, me kusht që të paraqesin dokumentin e regjistrimit pranë drejtorisë së shkollës të vendbanimit të tij.

Neni 2

Pas nenit 7 shtohet neni 7/a me këtë përmbajtje:

"Vendimi i dënimit jepet nga drejtori i shkollës. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te drejtori i drejtorisë arsimore në rreth, akti i të cilit është i formës së prerë. Drejtori i shkollës ia përcjell vendimin për gjobitje bashkisë ose komunës ku banon prindi, birësuesi a kujdestari i fëmijës, të cilat bëjnë vjeljen e gjobës dhe derdhjen e saj në buxhetin e shtetit, sipas rregullave për nxjerrjen e të ardhurave shtetërore.

Neni 3

Pas nenit 7/a shtohet neni 7/b me këtë përmbajtje:

"Ndalohet punësimi i fëmijës që përfshihet në detyrimin shkollor. Kur nga organet e pushtetit lokal vërtetohen raste të punësimit të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, punëdhënësi shtetëror apo privat dënohet për kundërvajtje administrative nga punonjësit e zyrës së punës me gjobë deri në 10.000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë deri në 20.000 lekë. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të tij, te përgjegjësi i zyrës së punës, akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.366, datë 24.11.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

